

REZOLUTË

PËR VEPRIMTARINË E KËSHILLIT KOMBËTAR TË INTEGRIMIT EVROPIAN PËRGJATË VITIT 2018

- Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe duke marrë në konsideratë rolin e Kuvendit, si organi më i lartë ligjvënës dhe kontrollues;
- Duke riafirmuar se objektivi strategjik i Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, dhe me mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që Bashkimi Evropian dhe shtetet e tij anëtare i kanë dhënë Shqipërisë në përmbushje të reformave integruese;
- Duke riafirmuar mbështetjen e palëkundur për të respektuar vlerat mbi të cilat ndërtohet Bashkimi Evropian dhe vendosmërinë për zhvillimin e një shoqërie demokratike, bazuar në sundimin e ligjit, respektin për të drejtat e njeriut dhe parimet e ekonomisë së tregut;
- Duke marrë në konsideratë faktin që gjithëpërfshirja dhe transparencja janë thelbësore për progresin e qëndrueshëm të Shqipërisë në procesin e integrimit evropian;
- Duke marrë në konsideratë reformat e ndërmarra në kuadër të procesit të integrimit evropian dhe përparimin e bërë nga Shqipëria në plotësimin e rekomandimeve kyçe të Komisionit Evropian dhe zbatimin e qëndrueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- Duke theksuar vendosmërinë tonë për krijimin dhe konsolidimin e një administrate publike eficiente, të aftë për të përballuar detyrimet e anëtarësimit, dhe forcimin e kapaciteteve të të gjitha grupeve të interesit;
- Duke theksuar rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të përfshirjes dhe rolit të shoqërisë civile në procesin integruës të vendit, me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në procesin e integrimit evropian;
- Duke theksuar synimin për forcimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të organeve, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e integrimit evropian;

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

1. Vlerësoi Raportin e Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian për vitin 2018 dhe rolin e tij në mbikëqyrje të progresit dhe përgatitjes për anëtarësim të arritur nga Shqipëria gjatë vitit 2018.
2. Përgëzon rolin e tij në drejtim të zhvillimit të dialogut gjithëpërfshirës mbi çështjet e integrimit evropian dhe inkurajon forcimin e mëtejshëm të rolit të tij në mbikëqyrje të reformave integruese të vendit dhe garantimit të gjithëpërfshirjes.
3. Vlerëson kontributin e vazhdueshëm të Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian për fuqizimin e kapaciteteve administrative në çështjet e integrimit evropian.
4. Thekson se angazhimi i qëndrueshëm për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe konkluzioneve të Këshillit Evropian përbën përparësinë kryesore të punës së Kuvendit të Shqipërisë dhe organeve, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e integrimit evropian, si Komisioni i Integrimit Evropian dhe Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian.
5. Shpreh vullnet të plotë për të ecur në rrugën e reformave në frymën e mirëkuptimit ndërpartiak dhe në bashkëpunim të plotë me shoqërinë civile dhe reflektimin e tij në veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian përgjatë vitit 2019.
6. I kërkon Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian të forcojë bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe me organet shtetërore, anëtarë të përhershëm apo me statusin e të ftuarit në Këshill, me qëllim përmirësimin cilësor të monitorimit të procesit të integrimit evropian.
7. I kërkon Këshillit Kombëtar të Integrimit Evropian të forcojë më tej rolin e tij si një forum kombëtar gjithëpërfshirës, cili nxit bashkëpunimin ndërmjet forcave politike, institucioneve

publike dhe shoqërisë civile dhe garanton transparencën për vendimmarrjen në çështjet e integritetit.

Miraturar në datën 30.5.2019.

KRYETAR
Gramoz Ruçi